VENDIM
Nr. 9, datë 26.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

me sekretare Blerina Basha, në datën 13.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 45/8, Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar në gjykim nga z.Artur Metani.

OBJEKTI: Papajtueshmëria e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal dhe e paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 68 e 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë Lushnjë, me vendimin nr. 362, datë 4.12.2014, ka vendosur: deklarimin fajtor të të pandehurit SH.B. për veprën penale të *vrasjes me dashje të mbetur në tentativë*, dhe në bazë të nenit 76 dhe 22 të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 12 vjet burg; deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe municionit", dhe në bazë të nenit 278/4 të KP-së dënimin e tij me 8 vjet burg. Në aplikim të nenit 55, në bashkim të dënimeve të mësipërme, i pandehuri është dënuar me 20 vjet burg. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së i është ulur 1/3-ta e dënimit dhe përfundimisht është dënuar me 13 vjet e 4 muaj burgim.

2. I pandehuri e ka apeluar çështjen pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, (gjykata referuese), duke kërkuar ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale "Vrasje me dashje" në tentativë në "Plagosje të rëndë me dashje", të parashikuar nga neni 88/1 i KP-së, dhe dënimin sa më të ulët për të pandehurin.

3. Gjykata referuese, me vendimin e ndërmjetëm nr. 583, datë 9.4.2015, ka vendosur pezullimin e çështjes dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë papajtueshmërinë me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës të paragrafit të dytë të nenit 55 dhe paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal.

4. Në nenin 55/2 të KP-së përcaktohet: "*Dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e*

përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale" (neni 9 i ligjit nr. 144/2013, që ka shtuar nenin 55 të KP-së).

5. Në paragrafin e katërt të nenit 278/4 të KP-së përcaktohet se *"mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet"* (*në vijim* gjykata do t'i referohet si paragrafi i pestë, pasi me ligjin nr. 98/2014, që ka ndryshuar nenin 278, paragrafi i katërt ekzistues është bërë paragrafi i pestë).

6. Gjithashtu, gjykata referuese, edhe pse pranon se i mungon kriteri lidhës me çështjen konkrete, për paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të nenit 278 të KP-së, i kërkon Gjykatës Kushtetuese që bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.10.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" të çmojë të shprehet me nismën e saj edhe për këto dispozita.

7. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin në seancë plenare të çështjes dhe shqyrtimin e saj mbi bazë dokumentesh.

II

8. ***Kërkuesja, gjykata referuese***, pretendon se nenet e sipërcituara bien ndesh me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, përkatësisht ndarjen e pushteteve, ushtrimin e pushtetit gjyqësor, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe kriteret kufizuese mbi proporcionalitetin lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur për sa vijon:

8.1. Ndërhyrja në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së cenon nenin 7 të Kushtetutës, pasi ligjvënësi ka ushtruar pushtetin gjyqësor kur ka përcaktuar mënyrën e caktimit të dënimit, duke i hequr mundësinë gjykatës të zbatojë kriteret ligjore të caktimit të dënimit, që është atribut i këtij pushteti.

8.2. Përcaktimi i ligjvënësit për të gjitha krimet kundër jetës që kryhen me dashje dhe shoqërohen me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të cilat janë jo më pak se 16 dispozita të Kodit Penal, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të zbatojnë rregullat e përcaktuara në nenet 47 dhe 55 të KP-së për gjykimin e këtyre veprave, duke cenuar ushtrimin e pushtetit gjyqësor, në kundërshtim me nenin 135/1 të Kushtetutës.

8.3. Ndërhyrja në nenin 55 është në kundërshtim edhe me nenin 145/1 të Kushtetutës, pasi ky rregullim, duke penguar gjykatat në dhënien e drejtësisë në caktimin e dënimit ndaj të pandehurve, cenon edhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

8.4. Sanksioni për mbajtjen e armëve, të bombave apo minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, parashikuar në nenin 278/5 të KP-së, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, si dhe nuk përmbush funksionin kryesor të dënimit, që nuk është ndëshkimi i fajtorit, por edukimi dhe rehabilitimi i tij, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, duke rënë ndesh me nenin 17 të Kushtetutës.

8.5. Ashpërsimi i dënimit dhe ndërhyrja në nenin 278 të Kodit Penal bie në kundërshtim edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012.

9. Subjekti i interesuar, ***Këshilli i Ministrave,*** ka paraqitur këto prapësime:

9.1. Ligjvënësi ka hapësirë të gjerë veprimi në ushtrimin e kompetencave legjislative. Ai është përgjegjës në hartimin e politikave penale, për rrjedhojë është brenda juridiksionit të tij legjislativ në përcaktimin e llogaritjes së dënimeve penale dhe masës së dënimeve.

9.2. Në ndryshimet e dispozitave ligjore objekt kundërshtimi, ligjvënësi është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

9.3. Parimi i proporcionalitetit përmban tri aspekte: përshtatshmërinë, nevojën dhe domosdoshmërinë, që do të thotë se ligjvënësi i ka pasur në konsideratë këto tri aspekte me ndryshimet e realizuara në paragrafin e dytë të nenit 55 dhe paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së.

9.4. Ligjvënësi me këtë rregullim të ri përjashtues ka pasur si synim ashpërsimin e masës së dënimit për autorët që dënohen për kategorinë e veprave penale të përfshira në krimet kundër jetës me dashje me përdorimin pa leje të armëve dhe municionit, për shkak të rritjes së kriminalitetit në këtë fushë.

10. Subjekti i interesuar, ***Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,*** nuk ka paraqitur prapësime para Gjykatës Kushtetuese.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese nëse plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese.

12. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën. Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret *(shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjykata referuese i ka plotësuar kriteret për inicimin e gjykimit incidental, duke identifikuar normat konkrete, duke argumentuar jokushtetutshmërinë e tyre bazuar në parimet dhe kërkesat kushtetuese, si dhe duke argumentuar se zgjidhja e çështjes konkrete varet nga zbatueshmëria e këtyre normave, për të cilat nuk kishte mundësi dhe hapësirë interpretimi, përveçse duke ushtruar kontrollin incidental ndaj tyre.

B. Për pretendimin se shtesa që i është bërë nenit 55/2 të KP-së vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, duke cenuar për këtë arsye parimin e ndarjes dhe pavarësisë së pushteteve

14. Gjykata referuese pretendon se me shtesën e realizuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së ligjvënësi i ka hequr të drejtën pushtetit gjyqësor të japë drejtësi, në përputhje me parashikimet e nenit 47/2 të KP-së, sipas të cilit në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po kështu, gjykata referuese pretendon se mjeti që ka përzgjedhur ligjvënësi për të arritur synimin e tij,

konkretisht: luftën kundër krimit të organizuar, sigurinë e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale, bie në kundërshtim me pavarësinë funksionale të gjykatave në atributin që kanë për dhënien e drejtësisë.

15. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se ligjvënësi ka hapësirë të gjerë veprimi në ushtrimin e kompetencave legjislative. Ai është përgjegjës në hartimin e politikave penale, për rrjedhojë është brenda juridiksionit të tij legjislativ për këtë rregullim të ri në lidhje me përcaktimin e dënimeve.

16. Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës janë: parimi i ndarjes së pushteteve, siguria juridike dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut *(shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Gjykata ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (*neni 1/b të KP-së*). Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (*neni 1/c të KP-së*). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve parashikohet në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit: "Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor". Ky formulim do të thotë se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në varësi të kësaj ndarjeje, fusha e ushtrimit të kompetencave nga institucionet e ndryshme kushtetuese varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera dhe nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 16 datë 10.4.2015; nr. 36 datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Po sipas Gjykatës, "pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave" *(shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Referuar këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se nëse me ndryshimet e bëra në rastin konkret ligjvënësi ka respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si i vetmi pushtet i ngarkuar nga kushtetutbërësi për dhënien e drejtësisë.

21. Gjykata konstaton se paragrafi i dytë i shtuar i nenit 55 të Kodit Penal objekt kundërshtimi parashikon se *dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.* Duket se qëllimi i ligjvënësit, duke shtuar këtë paragraf në nenin 55 të Kodit Penal, ka qenë që të detyrojë gjykatat që në të gjitha rastet kur personat kryejnë krime kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të aplikojnë si masë dënimi përfundimtar sistemin e mbledhjes aritmetike të dënimeve të caktuara më parë për secilën vepër penale.

22. Gjykata vëren se para shtesës së bërë në nenin 55 të Kodit Penal gjykatat nuk kishin asnjë pengesë që si dënim më të rëndë të shtuar të zbatonin mënyrën e mbledhjes aritmetike të dënimeve. Kështu, sipas paragrafit të parë të nenit 55 të Kodit Penal "*kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma dënim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar*". Ndërsa në paragrafin e tretë (ish-paragrafi i dytë para ndryshimeve) përcaktohet rregulli sipas të cilit "*dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve, të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë*".

23. Nga ana tjetër, Gjykata çmon me vend të nënvizojë se neni 55 i Kodit Penal zbatohet dhe duhet të zbatohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me nenin 47 të Kodit Penal, sipas të cilit "gjykata cakton dënimin, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara me ligj për veprën penale", dhe se "në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese".

24. Gjykata rithekson se ndonëse ligjvënësi në përcaktimin e veprave penale dhe llojit të dënimit ka fushë të gjerë veprimi, kjo liri është e kufizuar kur është fjala për vlerësimin e fajit si element i domosdoshëm i përgjegjësisë penale dhe në raport me shkallën e tij për caktimin e llojit dhe masës së dënimit konkret, pasi këto elemente janë të vlerësueshme vetëm nga gjykatat e zakonshme rast pas rasti (*shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Si pasojë, në përcaktimin e dënimit, për vepra të ndryshme penale, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete. Koncepti i fajit dhe përcaktueshmëria e pasojave juridike janë në një marrëdhënie tensioni njëra me tjetrën, marrëdhënie kjo për të cilën duhet gjetur një balancë funksionale kushtetuese (*shih vendimin BVerfGE 105, 135 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane).*

25. Prandaj kjo Gjykatë ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë kontekst, duke përcaktuar mënyrën e dhënies së dënimit, sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së të përmendura më lart (*prg. 23*), të cilat janë jo vetëm përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale, por njëkohësisht janë edhe në kompetencën ekskluzive të gjyqësorit. Në vlerësimin e Gjykatës ky rregullim i ri përbën cenim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë funksionale të pushtetit gjyqësor.

27. Si konkluzion, Gjykata arrin në përfundimin se shtesa e bërë në nenin 55, paragrafi i dytë i KP-së, cenon parimin e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe përbën kufizim të kompetencave në dhënien e drejtësisë. Për pasojë, pretendimi i gjykatës referuese se ky rregullim vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, është i bazuar.

C. Për pretendimin se ndryshimet e bëra në paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së cenojnë parimin e proporcionalitetit dhe si të tilla bien ndesh me nenin 17/1 të Kushtetutës

28. Kërkuesi pretendon se sanksioni i parashikuar në paragrafin e pestë të nenit 278 të Kodit Penal, sipas të cilit: *"Mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet*

tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet", është jo proporcional, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, në raport me veprat e tjera të këtij seksioni dhe të tjerat në Kodin Penal, dhe si i tillë vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

29. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se parimi i proporcionalitetit përmban tri aspekte: përshtatshmërinë, nevojën dhe domosdoshmërinë, që do të thotë se ligjvënësi, duke pasur në konsideratë këto tri aspekte, në ndryshimet në nenet 55 dhe 278 të KP-së, është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

30. Gjykata vëren se ligjvënësi në periudha kohore të ndryshme ka ndërhyrë në legjislacionin penal, si duke përcaktuar vepra të reja penale, ashtu edhe duke ndryshuar marzhet e masave të dënimit për t'iu përgjigjur shqetësimeve të shoqërisë, si pasojë e zhvillimit të kriminalitetit, në veçanti të krimit të organizuar. Gjykata ka theksuar edhe më parë se ndërhyrje të tilla të ligjvënësit jo vetëm duhet të synojnë uljen e kriminalitetit, por duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t'i shërbejnë në radhë të parë parandalimit të veprave penale.

31. Gjykata çmon se edhe në çështjen në shqyrtim, balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, janë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë. Është e vërtetë se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet, por kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio",* Gjykata vlerëson se ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe gjykatat homologe kushtetuese, si Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, sipas të cilës: "Parimi i proporcionalitetit rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, në fakt nga vetë thelbi i të drejtave themelore, sidomos i lirisë personale, të cilat duhet të kufizohen nga pushteti shtetëror vetëm në atë masë sa të jetë e domosdoshme për mbrojtjen e interesit publik. Pra, rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se edhe pse prej kohësh e drejta penale ka detyrën e mbrojtjes së bazave të një bashkëjetese të rregulluar në shoqëri, ajo nuk është mjeti kryesor i mbrojtjes ligjore, me gjithë karakterin e saj më të fuqishëm. Si pasojë, përdorimi i saj duhet t'u nënshtrohet kërkesave të parimit të proporcionalitetit. Për këtë arsye, neni 103, paragrafi 2 i ligjit themelor gjerman përcakton konceptin e thelbit të dënimit dhe raportin e fajit me dënimin, në kuptimin që çdo dënim duhet të jetë në një raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit" *(shih vendimet BVerfGE 19,342; BVerfGE 88,203; BVerfGE 45,187 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane).*

33. Ligji objekt shqyrtimi ka parashikuar disa ndryshime, të cilat referuar këtyre konsideratave Gjykata çmon t'i prezantojë për të analizuar, nga njëra anë, strategjinë e ndërhyrjes së ligjvënësit ndër vite dhe, nga ana tjetër, efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve në raport me respektimin e parimeve kushtetuese.

34. Me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", vepra penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve" u parashikua fillimisht në nenin 278, sipas të cilit: "Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo i minave, pa

lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet*. Mbajtja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet*. Mbajtja e fishekëve të armëve të lehta luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim deri në një vit.*".

35. Me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, në nenin 278 u bënë disa shtesa në paragrafët e parë dhe të dytë, ku pas fjalëve "minave", u shtuan fjalët "lëndët plasëse".

36. Me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 në nenin 278 u bënë disa shtesa dhe ndryshime ndërmjet të cilave u përcaktua se "mbajtja e municionit luftarak, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet",* si dhe "kur vepra kryhet në sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet *me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet*.".

37. Me ligjin nr. 144/2013, neni 278 u ndryshua për sa vijon: "Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, i lëndëve plasëse, i bombave apo i minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim *nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.* Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet *me gjobë ose me burgim deri në dy vjet*. Mbajtja e armëve, e bombave apo e minave ose e lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet *me burgim nga një deri në pesë vjet.* Mbajtja e armëve, e bombave apo e minave, ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga *shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet*. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet *me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.*".

38. Me ligjin nr. 98/2014 në nenin 278 u bënë disa ndryshime të tjera, ndërmjet të cilave u shtua një paragraf (i katërti) me këtë përmbajtje: "Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me *burgim nga pesë deri në tetë vjet.*". Gjithashtu, u ashpërsua masa e dënimit për vepra penale që kryhen në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose kanë sjellë pasoja të rënda, për të cilat dënimi me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet u zëvendësua me dënimin *me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet (paragrafi i gjashtë i nenit 278 të KP-së).*

39. Bazuar në këtë qasje historike të analizës së dispozitës, Gjykata evidenton se vepra penale e prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit, e parashikuar si e tillë në Kodin Penal të vitit 1995, ka pësuar ndryshime në kohë katër herë, përkatësisht në vitet 1998, 2001, 2013 dhe 2014.

40. Ligjvënësi në vitin 2001 ka ulur marzhin e dënimit minimal nga pesë në tre vjet për prodhimin e armëve dhe të municionit luftarak, të bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore (*neni 278/1 i ligjit nr. 8733*). Po me të njëjtin ligj është shtuar kryerja e së njëjtës vepër, por në sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose që ka sjellë pasoja të rënda (*neni 278/4 i ligjit nr. 8733).*

41. Ndërkohë në vitin 2013, ligjvënësi ka rritur marzhin e dënimit minimal dhe maksimal për prodhimin e armëve dhe të municionit luftarak, të bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente, nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 278/1 i ligjit nr. 144).* Po me këtë ligj, ligjvënësi ka parashikuar marzhe të ndryshme dënimi për mbajtje të armëve, të bombave apo minave ose lëndëve plasëse, por me diferencën e konsumimit në banesë, në automjete apo në mjedise publike dhe në mjedise të hapura për publikun *(neni 278/3/4 i ligjit nr. 144).* Gjithashtu, u rrit marzhi minimal i dënimit nga pesë në dhjetë vjet, si dhe marzhi maksimal nga pesëmbëdhjetë në njëzet vjet, kur kjo vepër kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda *(neni 278/5 i ligjit nr. 144).*

42. Për më tepër, në vitin 2014 ligjvënësi realizon një ndërhyrje tjetër në dispozitën penale objekt shqyrtimi në drejtim të rritjes së sanksioneve penale, si dhe në ndarjen e veprës penale, sipas llojit të armëve, përkatësisht *në mbajtje të armëve* në banesë (*prg. 3*) nga *mbajtje e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë*, (*prg. 4*), e cila nga një vepër që dënohej me burgim nga një deri në pesë vjet, aktualisht dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet" (*neni 278/3/4 ligjit nr. 98*). Kurse, kur kjo vepër kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet, duke u rritur përsëri marzhi minimal i dënimit nga dhjetë në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 278/6 i ligjit nr. 98*).

43. Bazuar në analizën historike të dispozitës, *në parim*, Gjykatës i rezulton se ligjvënësi është mbështetur thellësisht në strategjinë e ndërhyrjes ndëshkuese, e karakterizuar posaçërisht nga parashikimi i instrumenteve ashpërsuese, sikundër është rritja e marzheve minimale dhe maksimale të dënimit dhe përpjekja për të parashikuar të gjitha rastet dhe rrethanat e mundshme të prodhimit dhe të mbajtjes së të gjitha kategorive të armëve, municioneve luftarake, bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, në automjet, në mjete të motorizuara, në mjedise publike apo mjedise të hapura për publikun.

44. Në këto kushte, Gjykata gjen me vend të sjellë në vëmendje qëllimin e dënimeve penale në një shoqëri demokratike dhe parimet që duhet të udhëheqin ligjvënësin në caktimin e dënimeve penale.

45. Në lidhje me arsyen e ekzistencës së dënimit penal, Gjykata është shprehur se ai përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative. Nga njëra anë, qëndron *funksioni i parandalimit të përgjithshëm* të veprave penale, pasi kërcënimi se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo shtetas që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër, qëndron *funksioni i parandalimit të posaçëm*, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij, në mënyrë që pas kryerjes së dënimit të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i çfarëdolloj natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur parasysh edhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë edhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata vëren se ndryshimet e ndërmarra nga ligjvënësi në dispozitat objekt shqyrtimi (por edhe të tjera të shqyrtuara më parë nga kjo Gjykatë), kanë qenë përgjithësisht spontane, nisur nga synimi për të luftuar kriminalitetin, por pa iu nënshtruar më parë studimeve të thelluara për të shmangur prishjen e balancave jo vetëm midis masave të dënimit të veprave penale të një kapitulli, por edhe në raport me veprat e tjera penale, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të tyre. Një qasje (strategji) e tillë e gabuar ka deformuar strukturën e Kodit Penal, duke krijuar disproporcione të pashpjeguara (paarsyeshme) midis dënimeve të parashikuara për vepra të ndryshme të Kodit, në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe të proporcionalitetit, në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit. Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara (KM) nuk ishin në gjendje të argumentonin para kësaj Gjykate nevojën e domosdoshme për ndërhyrjen në Kodin Penal, duke u mjaftuar vetëm me argumente të përgjithshme, si p.sh. "kriminaliteti ka pësuar rritje" apo "për të luftuar krimin e organizuar".

48. Duke iu kthyer edhe një herë evidentimit të standardeve, Gjykata rithekson se përcaktimi me ligj i veprave të reja penale, si dhe caktimi i llojit dhe i masës së dënimit për to është në diskrecion të ligjvënësit, në përputhje me nevojat e vendit dhe të shoqërisë për parandalimin e kriminalitetit.

Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, janë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata, për të arritur në një përfundim të drejtë nëse ndërhyrjet e ligjvënësit në nenin 278 të Kodit Penal janë proporcionale në raport me gjendjen që i ka diktuar, e sheh me vend të bëjë një vështrim krahasues midis paragrafëve të vetë nenit, midis nenit 278 dhe dispozitave të tjera të të njëjtit kre, midis nenit 278 dhe veprave të ndryshme penale që kryhen me përdorimin e armëve dhe midis Kodit tonë Penal për veprën në fjalë dhe kodeve penale të vendeve të rajonit.

50. Veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, në automjete apo çdo mjet të motorizuar, ose në mjedise publike, bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale që cenojnë rendin dhe sigurinë publike brenda seksionit III "Mbi veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike".

51. Duke iu referuar, së pari, paragrafëve të ndryshëm të nenit 278 të KP-së rezulton se *mbajtja e armëve në banesë* pa lejen e organeve kompetente dënohet nga një deri pesë vjet *(prg. 3*). Më tej, *mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë* dënohet nga pesë deri në tetë vjet (*prg. 4*), kurse *mbajtja e armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, dënohet* nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, dallim që nuk e justifikon arsyen apo qëllimin e këtij ndryshimi (*prg. 5*).

52. Gjykata vëren se sipas doktrinës së të drejtës penale, prodhimi apo mbajtja pa lejen e organeve kompetente të armëve luftarake është element thelbësor i anës objektive të kësaj vepre penale. Ligjvënësi e ka konsideruar vepër të dënueshme penalisht mbajtjen e armëve pa leje, pavarësisht nga qëllimi i mbajtjes së tyre (për t'i përdorur ose jo). Në këtë kontekst, Gjykata e sheh të pajustifikuar përpjekjen e ligjvënësit për të përcaktuar rrezikshmërinë e kësaj vepre penale dhe përcaktimin e masës së dënimit nisur nga kritere të tilla, si lloji i armës luftarake, dhe në veçanti vendi i mbajtjes së tyre (banesë, automjet, vendi i punës etj.). Për më tepër, Gjykata i konsideron joproporcionale dallimet në masat e dënimit të paragrafit të pestë të KP-së dhe paragrafëve të tretë dhe të katërt të këtij neni. Për ilustrim, një qytetar që mban një armë pa leje në banesë për të mbrojtur pronën, veten apo familjen, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim. I njëjti person kur armën e mban për të njëjtën arsye në automjetin e tij, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

53. Gjykata e konsideron joproporcionale ndërhyrjen në paragrafin e pestë të nenit 278 të Kodit Penal, duke e krahasuar këtë dispozitë edhe me të tjera që ndodhen në të njëjtin kre të Kodit, "Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike". Kështu, trafikimi i armëve dhe municioneve, një krim ndërkombëtar, dënohet sipas Kodit Penal nga shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet burgim (*neni 278/a, paragrafi i parë*). Të njëjtën masë dënimi ligjvënësi ka parashikuar edhe për veprat penale të trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive (*neni 282/a, paragrafi i parë*) etj.

54. Gjykata vlerëson se armët nuk përfaqësojnë gjë tjetër veçse mjetin për të kryer vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilat prekin kryesisht marrëdhëniet shoqërore që lidhen me mbrojtjen e jetës. Në këtë kuptim, edhe dënimet e parashikuara për to duhet të jenë në proporcion të drejtë me natyrën e krimit të kryer nëpërmjet përdorimit të tyre. Veprat penale mbulojnë një shkallë të gjerë veprimesh ose mosveprimesh, të cilat dallojnë mes tyre për sa i përket natyrës së shkeljes dhe rrezikut që i kanoset interesit që ligji synon të mbrojë. Mjafton t'u referohemi disa veprave të parashikuara në seksione të ndryshme të Kodit Penal, që kryhen nëpërmjet

përdorimit të armëve, për të arritur në përfundimin se ndryshimet objekt shqyrtimi janë disproporcionale.

55. Gjykata vëren se vrasja e kryer nga një person me një armë që e mban pa leje, në gjendjen e tronditjes së fortë psikike të çastit, të shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës, dënohet me burgim gjer në tetë vjet (*neni 82, sek.I, "Krime kundër jetës të kryera me dashje"*). Ndërsa, për armën që ka shërbyer si mjet për kryerjen e krimit, dënimi do të ishte jo më pak se shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta logjikë vlen edhe për vrasjen e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, që dënohet me burgim gjer në shtatë vjet (*neni 83, sek.I, "Krime kundër jetës të kryera me dashje"*).

56. Në të njëjtën linjë arsyetimi mund të përmenden edhe vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore që kryhen me përdorimin e armëve. Gjykata konstaton se - vrasja me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet (*neni 76*); - marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 104*); - shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë me përdorimin e armës dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 109/b/2*); - rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera me kërcënim me armë dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet (*neni 111*) etj.

57. Po në mbështetje të këtij argumenti mbi disproporcionalitetin e dënimeve për vepra penale të përcaktuara në seksione dhe krerë të ndryshëm, bazuar në shkallën e rrezikshmërisë së tyre shoqërore, Gjykata konstaton se Kodi Penal parashikon të njëjtin marzh dënimi me atë të parashikuar në paragrafin e pestë të Kodit Penal edhe për vepra të tjera penale me rrezikshmëri tejet të lartë shoqërore. Kështu, vepra penale mbi trafikimin e personave të rritur, e parashikuar te seksioni VII "Vepra penale kundër lirisë së personit", dhe më konkretisht, organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 110/a/3*). Gjithashtu, te kreu VII "Vepra me qëllime terroriste", prodhimi, mbajtja, transportimi i armëve luftarake, kimike, biologjike, bërthamore, me bazë helmuese ose eksplozive, me qëllim për të kryer vepra terrori, dënohen me burgim nga pesë deri pesëmbëdhjetë vjet (*neni 234*). Ndërsa pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet (*neni 234/a, prg. 2*).

58. Përveç argumenteve të sipërpërmendura, Gjykata e konsideron me vend të shtojë se ndërhyrjet në legjislacion lidhur me veprat penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike janë tejet të ashpra edhe në raport me disa vende evropiane. Për të argumentuar sa më lart, ajo vlerëson të ofrojë dhe një qasje krahasimore në lidhje me veprën penale të prodhimit apo mbajtjes pa leje të armëve apo lëndëve të tjera plasëse të kodeve penale të disa vendeve të rajonit, si dhe më gjerë, listuar për sa vijon:

58.1. Kodi Penal i Malit të Zi **në nenin 403** "**Mbajtja e paligjshme e armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyese**" **parashikon:** "1. Çdo person i cili pa leje prodhon, shet, siguron, shkëmben, mbart ose mban armë zjarri, municione apo lëndë shpërthyese, dënohet me burgim për një periudhë *jo më shumë se tre vjet*. 2. Nëse objekti i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është një pjesë e armës së zjarrit, municion, eksploziv apo armë gazi, prodhimi, shitja, blerja, shkëmbimi, ose mbajtja e së cilës është e ndaluar për qytetarët, personi *dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet*. 3. Nëse objekti i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përbën një sasi të madhe të armëve ose ajo është një armë me fuqi të madhe shkatërruese, personi *dënohet me burgim nga një vit deri në tetë vjet."*.

58.2. Kodi Penal i Maqedonisë në **nenin 396** "**Mbajtja e paligjshme e armëve dhe materialeve eksplozive**" parashikon: "1. Çdo person i cili pa pasur leje prodhon, shet, siguron ose shkëmben armë zjarri, municione apo lëndë shpërthyese, apo një person i cili pa leje mban armë zjarri, municione ose lëndë shpërthyese, të cilat janë të ndaluara për qytetarët, *dënohet me burgim nga një deri në 10 vjet*. 2. Nëse objekti i veprës së parashikuar në paragrafin 1 është një sasi shumë e madhe armësh zjarri, municionesh apo lëndësh shpërthyese, shkelësi *dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet*. 3.

Nëse veprat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 kryhet duke qenë pjesë e një grupi, organizate apo organizimi tjetër kriminal, autori i veprës *dënohet me burgim deri 8 vjet.".*

58.3. Kodi Penal i Serbisë në nenin 348 parashikon: "1. Çdo person i cili pa autorizim prodhon, shet, blen, shkëmben apo zotëron armë zjarri, pjesë të tyre, municione apo eksplozivë, *dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet dhe me gjobë*. 2. Nëse objekti i veprës penale të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni janë armët e zjarrit, municionet, eksplozivët apo substancat, të cilat janë të ndaluara për publikun, personi *dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë*. 3. Nëse objekti i veprës penale të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është një sasi e madhe armësh, municioni dhe pajisjesh të tjera me fuqi të madhe shkatërruese ose vepra është kryer në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, personi *dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet*. 4. Çdo person që kryen veprat penale të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji me armë pa licencë dënohet me *burgim nga dy deri në dhjetë vjet*. 5. Çdo person që kryen veprat penale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni pa leje, megjithëse ka leje për të blerë dhe për të mbajtur objekte të njëjta, *dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vje*t.".

58.4. Kodi Penal i Kroacisë në nenin 335 "Posedimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyese" parashikon: "1. Çdo person që pa autorizim përgatit, siguron, posedon apo në çfarëdo mënyre siguron për veten e tij apo një të tretë armë zjarri, municion ose substanca shpërthyese në mënyrë të paligjshme, dënohet *me gjobë ose burgim jo më shumë se tre vjet*. 2. Çdo person që pa autorizim siguron, zotëron, shet, prodhon ose shkëmben sasi të mëdha të armëve të zjarrit, municionit apo substancave shpërthyese, *dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.".*

58.5. Kodi Penal i Bullgarisë në nenin 337 parashikon: "1. Çdo person i cili prodhon, përpunon, riparon, krijon, mban, tregton, transporton, importon apo eksporton lëndë shpërthyese, armë zjarri, kimike, biologjike apo bërthamore ose municione, pa pasur leje për ta bërë një gjë të tillë nga organi respektiv, apo vepron në kundërshtim me parashikimet e lejes së dhënë, dënohet *një deri në gjashtë vjet burgim*. 2. Dënimi është *nga dy deri në tetë vjet burgim* kur akti është kryer nga: a) një zyrtar që përfiton nga pozita e tij zyrtare; b) kur është përsëritës, përveç rastit kur personi është minoren. 3. Kur krimi kryhet në sasi të mëdha, *dënimi është nga tre deri në dhjetë vjet burgim*. 4. Kur krimi kryhet në sasi veçanërisht shumë të mëdha dhe çështja është veçanërisht e rrezikshme, dënimi është *nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.".*

58.6. Kodi Penal i Sllovakisë në seksionin 294 "Blerja dhe mbajtja e armëve të zjarrit dhe trafikimi i tyre" parashikon: 1. Çdo person i cili për vete apo dikë tjetër fabrikon, importon, eksporton, transporton, siguron apo zotëron municione pa licencë ose kush ndërmjetëson një aktivitet të tillë, dënohet *me burgim nga një deri në pesë vjet*. 2. Çdo person i cili për vete apo dikë tjetër fabrikon, importon, eksporton, siguron apo zotëron një armë zjarri, pjesë apo elemente përbërëse të saj pa pasur licencë ose pa pasur një markë identifikimi të armës sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Sllovakisë është palë nënshkruese, apo i cili ndërmjetëson një aktivitet të tillë, *dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet* […] 4. Personi dënohet *me burgim nga katër deri në dhjetë vjet* nëse kryen veprën sipas paragrafëve 1, 2 ose 3: a) duke vepruar në një mënyrë të rëndë; b) për shkak të një motivi të veçantë; c) në një shkallë më të gjerë. 5. Personi dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet në qoftë se e kryen veprën sipas paragrafëve 1, 2 ose 3: a) si anëtar i një grupi me rrezikshmëri shoqërore; b) në një shkallë më të gjerë; c) nën një situatë krize".

59. Për të njëjtat arsye të marra në analizë më lart, Gjykata çmon se ligjvënësi ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike, pasi ky parim lidhet me plotësimin e disa kërkesave paraprake të detyrueshme gjatë procesit ligjvënës. Sipas Gjykatës, parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohet që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të. Një rregullim i pasaktë i normës

ligjore dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma *(shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Me ndërhyrjen në nenin 278 të KP-së ligjvënësi nuk ka respektuar aspektin harmonik që duhet të kenë dispozitat e Kodit Penal, të cilat në tërësinë e tyre duhet të përbëjnë një entitet të vetëm, ku të bashkohen vlerat dhe parimet kryesore që udhëheqin këtë kod, që janë shteti i së drejtës, barazia para ligjit, drejtësia në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe humanizmi (*neni 1/c i Kodit Penal*).

60. Gjithashtu, po në këtë drejtim, kjo Gjykatë thekson se që ligji të kuptohet saktë dhe drejt duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Gjykata konstaton se në relacionin bashkëshoqërues të ligjit nuk ka argumente të mjaftueshme mbi domosdoshmërinë e këtij mjeti ashpërsues. Për më tepër, Kuvendi, si palë e interesuar, nuk paraqiti argumente kushtetuese mbi nevojën, përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë e ashpërsimit të dënimit të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në mjedise publike apo të hapura për publikun, parashikuar në nenin 278/5 të KP-së, si e vetmja mënyrë për arritjen e qëllimit të ligjvënësit në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe sigurisë së rendit publik edhe shoqëror. Në këto kushte, Gjykata vëren paqartësi dhe spontanitet në qëllimin e përzgjedhjes së mjetit të ashpërsimit të dënimit, për rrjedhojë edhe kjo është një arsye e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

61. Bazuar mbi analizën e mësipërme, Gjykata gjen rastin të përsërisë qëndrimin e saj të mëparshëm dhe të sjellë në vëmendje të ligjvënësit se ndërhyrje të tilla duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t'i shërbejnë jo vetëm luftës ndaj kriminalitetit, por për më tepër parandalimit të kryerjes së veprave penale. Kjo gjykatë ka evidentuar edhe me vendime të mëparshme se eksperienca ka treguar që ashpërsimi jo proporcional i sanksioneve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislacionit penal. Si pasojë, gjatë përcaktimit të dënimit, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit. Ai duhet që nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete, në përputhje me kërkesat e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 65, datë 10.12.1999*; *nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se paragrafi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal bie në kundërshtim me parimet kushtetuese të proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike, për rrjedhojë duhet shfuqizuar.

63. Përveç sa më lart, Gjykata në ushtrim të kompetencave të saj, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vlerëson të shprehet me nismën e saj edhe mbi paragrafin e gjashtë të nenit 278 të KP-së. Në këtë dispozitë parashikohet se *kur vepra kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.*

64. Gjykata konstaton se paragrafi i gjashtë i nenit 278 të KP–së, mbart të njëjtat probleme kushtetutshmërie, si dhe paragrafi i pestë i nenit 278, i konsideruar si i papajtueshëm me Kushtetutën. Sipas Gjykatës, edhe ky dënim është dukshëm joproporcional. Për më tepër, dhe shprehja "pasoja të rënda" është e paqartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë edhe ky paragraf duhet shfuqizuar.

65. Ndërsa për pretendimin për shfuqizimin e paragrafëve 1, 3 dhe 4 të nenit 278 të KP-së, për shkak se bien në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, Gjykata, pasi i mori në analizë, arriti në konkluzionin se nuk kanë elemente të papajtueshme me Kushtetutën.

66. Si konkluzion, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55, si dhe paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, për shkak se bien në kundërshtim me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/ 1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013[1], si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014[2].

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice për secilën nga dispozitat objekt gjykimi.

A. Për pretendimin për cenimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit për shkak të shtesës në nenin 55/2 të KP-së, në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka vlerësuar se paragrafi i dytë i nenit 55 të KP–së ndërhyn në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin e dënimit dhe dhënien e drejtësisë, për rrjedhojë vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës dhe si i tillë duhet shfuqizuar (*prg.27 i vendimit*).

3. Shumica është shprehur se neni 55 i KP-së zbatohet dhe duhet të zbatohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me nenin 47 të Kodit Penal, sipas të cilit "gjykata cakton dënimin, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara me ligj për veprën penale", dhe se "në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese" (*prg. 23 i vendimit*). Përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në këtë kontekst, duke përcaktuar mënyrën e dhënies së dënimit, sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP–së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së (*prg. 25-26 i vendimit*).

4. Duke pasur parasysh sa më sipër, duket se shumica në thelb i referohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Ndryshe nga sa argumenton shumica, ne mendojmë se duke zbatuar paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së në caktimin e dënimit, gjykata nuk pengohet në individualizimin e dënimit për veprat penale të krimeve kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, për rrjedhojë ajo nuk pengohet në ushtrimin e atributit gjyqësor, dhënien e drejtësisë.

---

[1] Votuan kundër shfuqizimit të këtij neni gjyqtarët: S. Berberi, B.Imeraj dhe F.Lulo.

[2] Votuan kundër shfuqizimit të këtyre paragrafëve gjyqtarët: B.Dedja, S. Berberi dhe B.Imeraj.

5. Në vlerësimin tonë, shumica në gjykimin e kësaj çështjeje nuk ka bërë dallimin mes individualizimit të dënimit *in concreto*, si kompetencë ekskluzive e pushtetit gjyqësor, dhe kompetencës së ligjvënësit për të përcaktuar rregulla *in abstracto* mbi metodologjinë e caktimit të dënimeve.

6. Në lidhje me kontrollin kushtetues të normës penale që përcakton kualifikimin e veprës penale, llojin e dënimeve dhe masën e dënimeve si kompetencë e ligjvënësit, kjo gjykatë ka dhënë në vazhdimësi disa vlerësime në jurisprudencën e saj. Kështu, Gjykata ka theksuar se Kuvendi, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, vendos dhe konkretizon politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi ose u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve ashtu, si dhe vetë masa e tyre është diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Megjithatë, ligjet ose dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara nuk shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 55 datë 21.7.2015, nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

7. Paragrafi i dytë i shtuar, i cili është bërë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese, përcakton se *dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.* Ndërkohë, paragrafi i parë sanksionon se *kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, për të cilat nuk është dhënë akoma dënim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.*

8. Referuar paragrafit të dytë të shtuar të dispozitës objekt gjykimi rezulton se gjykatat gjatë gjykimit të veprave penale të lidhura me krimet e vrasjes me dashje, të kryera me përdorimin e armëve, kanë të drejtën e përcaktimit të secilit dënim më vete sipas nenit 47 të KP–së, pra vlerësimin e caktimit të dënimit për secilin nga veprimet apo mosveprimet kriminale, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ndërsa në momentin e dhënies së dënimit përfundimtar, si "dënimi më i rëndë i shtuar", duhet të bëjnë mbledhjen aritmetike të shumës së dënimeve të dhëna veç e veç. Me zbatimin e paragrafit të parë, gjykatat e kishin në vlerësimin e tyre që si dënim përfundimtar të jepnin jo domosdoshmërish shumën e përgjithshme të dënimeve për secilën vepër penale.

9. Sipas parashtrimeve të subjektit të interesuar (KM), synimi i ligjvënësit për këtë ndërhyrje është bërë me qëllim forcimin e luftës kundër kriminalitetit për veprat penale të vrasjes me dashje, të realizuara me armë pa leje. Po sipas këtij subjekti, ky synim nuk arrihej duke aplikuar rregullat e përgjithshme të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 55 të KP–së, por duke parashikuar rregulla të reja përllogaritjeje të dënimit, me qëllim që të garantohej vuajtja e plotë e dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilët nuk duhej të përfitonin ulje në dëm të interesit publik që mbrohet në këtë rast.

10. Ky qëllim i ligjvënësit shpjegon arsyen për miratimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP-së, i cili parashikon një rregullim specifik, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për sa i përket diskrecionit në përllogaritjen e "dënimit më të rëndë të shtuar". Gjyqtari, referuar paragrafit të dytë të nenit 55, për gjykimin e autorëve të akuzuar për krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, është i detyruar të aplikojë si dënim përfundimtar shumën e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.

11. Çështja që është shtruar përpara Gjykatës në rastin konkret është nëse dispozita objekt shqyrtimi kufizon diskrecionin e gjykatës për caktimin e dënimit përfundimtar deri në atë pikë sa të cenojë atributin e gjykatës për dhënien e drejtësisë në mënyrë të pavarur.

12. Ne çmojmë se në rastin konkret paragrafi i dytë i nenit 55 të KP-së ka rregulluar mënyrën e llogaritjes së dënimit për një kategori të caktuar veprash penale, pa i hequr të drejtën gjykatës që në

fazën e parë, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, rrezikshmërinë e autorit, të veprës, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura, të caktojë llojin dhe masën e dënimit për autorin e veprave penale veç e veç. Për rrjedhojë, gjykata bën individualizimin e dënimit për çdo vepër penale në përputhje me funksionin e saj të dhënies së drejtësisë. Prandaj, pakica vlerëson se gjyqtari ka pavarësi të plotë për të proceduar mbi individualizimin e dënimit për secilën nga veprat penale, brenda hapësirës që lejon vepra përkatëse. Ndërsa, në fazën e dytë, për dhënien e vendimit përfundimtar, ligjvënësi ia ka kufizuar diskrecionin gjykatës në përllogaritjen përfundimtare të dënimit më të rëndë të shtuar, pasi është atribut i pushtetit ligjvënës parashikimi i instrumenteve dhe mekanizmave ligjorë efikasë për arritjen e qëllimeve të caktuara në fushën e politikave penale.

13. Për sa më lart, në gjykimin tonë, thelbi i së drejtës, që është dhënia e vendimit për secilën vepër penale nga gjykata në mënyrë të pavarur bazuar në nenin 47 të KP–së, nuk është cenuar. Për më tepër, ky rregullim përjashtimor është bërë jo për të gjitha llojet e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, por vetëm për ato të parashikuara në kreun "Krime kundër jetës të kryera me dashje", të realizuar me përdorimin e armëve pa leje.

14. Gjithashtu, pakica vlerëson të sjellë si argument bindës një vendim të gjykatës homologe rumune për një normë të ngjashme të shqyrtuar prej saj mbi përllogaritjen e dënimeve, me këtë përmbajtje: *Në rast të kryerjes së disa veprave penale, përcaktohet dënimi për secilën vepër individualisht dhe dënimi aplikohet për sa vijon: " (...) b) kur janë përcaktuar vetëm dënime me burgim, duhet të zbatohet dënimi më i rëndë, i cili mund të shtohet me 1/3-ën e totalit të të gjitha dënimeve të tjera (...)*". Kjo gjykatë e ka rrëzuar kërkesën për papajtueshmëri me Kushtetutën, duke konkluduar se *"përcaktimi i dënimit penal për kryerjen e disa veprave, që përfshin veprat për të cilat janë përcaktuar vetëm dënime me burgim, duke aplikuar sistemin komulativ (mbledhës/grumbullues) me shtim të detyrueshëm dhe fiks, bie në juridiksionin e ligjvënësit, në përputhje me rolin e tij kushtetues si i vetmi autoritet ligjvënës i vendit"* (*vendim i Gjykatës Kushtetuese Rumune nr. 711, datë 27 tetor 2015, prg. 4, përkthim i Gjykatës).*

15. Për të gjitha këto, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se pretendimet mbi papajtueshmërinë e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP–së me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës nuk janë të bazuara.

B. Për pretendimin se ndryshimet e bëra në paragrafin pestë të nenit 278 të KP-së cenojnë parimin e proporcionalitetit dhe si të tilla bien ndesh me nenin 17/1 të Kushtetutës

16. Shumica ka konkluduar se paragrafi i pestë i nenit 278 të KP-së bie në kundërshtim me parimet kushtetuese të proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike, për rrjedhojë duhet shfuqizuar (*prg. 62 i vendimit*).

17. Për të vlerësuar shkeljen e standardeve të kërkuara mbi proporcionalitetin shumica ka përdorur si metodologji qasjen krahasimore. Sipas saj: *"Gjykata, për të arritur në një përfundim të drejtë nëse ndërhyrjet e ligjvënësit në nenin 278 të KP-së janë proporcionale në raport me gjendjen që i ka diktuar, e sheh me vend të bëjë një vështrim krahasues midis paragrafëve të vetë nenit, midis nenit 278 dhe dispozitave të tjera të të njëjtit kre, midis nenit 278 dhe veprave të ndryshme penale që kryhen me përdorimin e armëve dhe midis Kodit tonë Penal për veprën në fjalë dhe kodeve penale të vendeve të rajonit" (prg. 49 i vendimit*).

18. Konstatojmë se shumica për të analizuar shkeljen e parimit të proporcionalitetit i referohet vetëm krahasimit nga pikëpamja normativiste e dispozitës objekt shqyrtimi në raport me dispozitat e tjera të KP-së, pa u mbështetur në argumente faktike, të dhëna statistikore apo konkluzione që vlerësojnë proporcionalitetin.

19. Gjykata ka çmuar në jurisprudencën e saj se vendosja me ligj e llojit të dënimeve, ashtu si dhe vetë masa e tyre është diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive

të individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në përputhje me parimin e proporcio-nalitetit është thelbësore për ligjvënësin të përcaktojë se cilat janë ato veprime të individit që konsiderohen të dënueshme dhe në këtë kuptim nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse ky vlerësim është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës penale është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe parimet themelore kushtetuese *(shih vendimin nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Po kështu, Gjykata, në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, ka zbërthyer kriteret për të vlerësuar nëse një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit. Këto kritere janë: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin- ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme" (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këtë këndvështrim vlerësojmë se tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës: i) nevoja; ii) përshtatshmëria; iii) domosdoshmëria, i imponojnë ligjvënësit të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në ashpërsinë e dënimit si masë kufizimi e lirisë së personit, si dhe të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. ashpërsia e dënimit të jetë e zgjedhur në mënyrë të tillë që të jetë të përshtatshme për parandalimin e veprave penale të krimit kundër jetës të kryera me armë pa leje. Gjithashtu, domosdoshmëria e detyron ligjvënësin të vërtetojë se synimi i parandalimit të kryerjes së veprave penale të krimit kundër jetës me armë pa leje, nuk mund të arrihet me mjete të tjera dhe se ka përdorur mjetin më pak të dëmshëm (ashpërsimin) për subjektet që u kufizohet liria për shkak të konsumimit të kësaj vepre penale.

23. Bazuar në këto vlerësime mendojmë se në rastin konkret, lidhur me ashpërsimin e dënimit për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar ose mjedise publike, pa lejen e organeve kompetente, duhen ballafaquar pretendimet e kërkueses/gjykatës referuese dhe prapësimet e subjektit të interesuar.

24. Kështu, gjykata referuese pretendon se sanksioni për mbajtjen e armëve, bombave minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, që parashikon burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, sipas paragrafit të pestë të nenit 278 të KP-së, nuk i përgjigjet dukshëm rrezikshmërisë shoqërore të veprës, si dhe nuk përmbush funksionin kryesor të dënimit, që nuk është ndëshkimi i fajtorit, por edukimi dhe rehabilitimi i tij, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, duke rënë ndesh me nenin 17 të Kushtetutës.

25. Ndërsa subjekti i interesuar prapëson se në ndryshimet e dispozitave ligjore objekt kundërshtimi, ligjvënësi është udhëhequr nga interesi publik, konkretisht nga lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale.

26. Edhe duke iu referuar relacionit bashkë-shoqërues të ligjit rezulton se: "*...ndryshimi i legjislacionit në përputhje me evolucionin e shoqërisë dhe të problematikave është detyrë parësore e organeve të shtetit. Ministria e Drejtësisë ka gjykuar si thelbësore ndryshimet në Kodin Penal, me qëllim dhënien e një përgjigjeje sa më të përshtatshme dhe efektive problematikave në rritje apo të reja në fushën penale. Me këto ndryshime është synuar forcimi i luftës ndaj kriminalitetit, duke ashpërsuar dënimet për veprat penale të rënda dhe duke parashikuar rregulla të reja, me qëllim garantimin e vuajtjes së plotë të dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore*".

27. Në analizë të të dhënave të mësipërme vlerësojmë se parimi i proporcionalitetit kërkon që në thelb masa të jetë mjaftueshëm e rëndësishme për të justifikuar kufizimin e së drejtës dhe të jetë e nevojshme aq sa për të arritur objektivin e ligjshëm. Nga ana tjetër, ashtu sikundër ka theksuar dhe më parë, kjo Gjykatë prezumon pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse para Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 25.7.2008*; *12, datë 14.4.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*

28. Në rastin konkret, pakica vlerëson se interesi i ligjvënësit për forcimin e luftës ndaj kriminalitetit ka qenë mjaftueshëm i rëndësishëm për të ndërhyrë në nenin 278 të KP-së. Sipas pakicës, nga kërkuesi nuk janë paraqitur argumente të mjaftueshme për të vërtetuar që ka pasur mjete të tjera më pak të ashpra për të arritur qëllimin e kërkuar, të cilat do ta çonin Gjykatën në konkluzionin se ka mjete të tjera më pak kufizuese. Në këtë kuptim, pakica vlerëson se argumentet e shumicës për joproprocio-nalitetin e mjetit të përdorur nga ligjvënësi në ashpërsimin e dënimit për veprën penale të parashikuar në paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së nuk janë bindëse. Për më tepër, edhe krahasimi me kodet penale të vendeve të tjera evropiane në këtë rast nuk mund të jetë kriter përcaktues për arritjen në konkluzione, pasi ashpërsimi ose zbutja e marzheve të dënimit varion nga situata e kriminalitetit në vend dhe ligjvënësi disponon mjetet e tij të reagimit për të përmirësuar situatën. Situatat mbi kriminalitetin në vende të ndryshme janë të ndryshme, për rrjedhojë edhe ndërhyrja mund të jetë në forma dhe mënyra të ndryshme (*prg. 58 i vendimit*).

29. Në mbështetje të këtij qëndrimi e gjejmë me vend të theksojmë se lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, ligjvënësi ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 55 datë 21.7.2015, nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Pakica evidenton se ajo i përmbahet linjës dhe qëndrimeve të shprehura edhe në disa vendimmarrje të tjera të Gjykatës Kushtetuese, për kontrollin kushtetues të normës penale në raport me atributet e pushtetit gjyqësor për dhënien e drejtësisë, balancën mes pushteteve dhe testin e proporcionalitetit sikundër është vendimi nr. 55 datë 21.7.2015*,* si dhe vendimi nr. 71, datë 27.11.2015.

30. Ky qëndrim i pakicës është në të njëjtën linjë me qëndrime të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane kur ka theksuar se "ligjvënësi ka të drejtë të vendosë vetë për llojin dhe masën e veprave të dënueshme penalisht, duke caktuar edhe hapësirën e lejueshme brenda të cilës mund të veprojë gjyqtari. Parashikimi i elementeve thelbësore që bëjnë dallimin midis veprave të ndryshme penale dhe dënimeve përkatëse të tyre është në vlerësimin e ligjvënësit. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të vlerësojë nëse rregullimi ligjor është më i drejti apo më i përshtatshmi për arritjen e qëllimit të shprehur nga ligjvënësi. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse kufijtë e jashtëm të hapësirës vlerësuese të ligjvënësit janë kapërcyer ose jo" (*Vendim i GJKF-së Gjermane 105 BVERFGE 135 (154) (2002).*

31. Përveç këtyre konsideratave, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se shumica me këtë vendim, duke shfuqizuar paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së, mund të krijojë paqartësi dhe pasiguri në organet ligjzbatuese dhe më konkretisht gjykatat e zakonshme, në lidhje me perspektivën e çështjeve konkrete, në gjykimin e autorëve të akuzuar për kategorinë e veprës penale objekt shqyrtimi.

32. Për shfuqizimin me nismën e Gjykatës, të paragrafit të gjashtë të nenit 278 të KP-së, pakica i qëndron së njëjtës linjë të argumenteve për rrëzimin e kërkesës si për paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së.

33. Në konkluzion, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se pretendimet e gjykatës referuese për papajtueshmërinë e paragrafit të dytë të nenit 55 të KP–së dhe paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP–së nuk qëndrojnë, prandaj kërkesa duhej rrëzuar si e tërë.

Anëtarë: Bashkim Dedja[3] (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatos Lulo[4]

[3] Kryetari Bashkim Dedja i bashkohet kësaj pakice vetëm në lidhje me qëndrimin dhe argumentet mbi paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së.

[4] Gjyqtari Fatos Lulo i bashkohet kësaj pakice vetëm në lidhje me qëndrimin dhe argumentet mbi paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së.